



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 535/6 prot.

Tiranë, më 22.10.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr.173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artan Madani
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 7.10.2019, është njoftuar vendimi nr.173, datë 1.7.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Artan Madani, me funksion prokuror/Drejtuës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Kavajë.

Ndërkohë, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c” të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 29.7.2019, është depozituar akti: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr.173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, me detyrë prokuror/Drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjirokastrë, Kavajë, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit duke filluar nga muaji shtator 1993 e në vijim dhe aktualisht është prokuror/Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, Kavajë.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Artan Madani ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Artan Madani”, ka referuar:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, fillimisht ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës” për subjektin. DSIK, pas ardhjes në djeni nga autoritetet verifikuese të aktivitetit të paligjshëm të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z.***.***, në Republikën e Italisë, për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, me shkresën nr.*** prot., datë ***.1.2019, ka përcjellë raportin e rishikuar mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Madani, në të cilën ka konstatuar [...]...nga përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës[...].

3.3 GPPP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] Pasi hetoi dhe shqyrtoi të gjithë dokumentacionin në lidhje me dy pasuritë e subjektit, përkatësisht apartament dhe garazh, kursime ndër vite në shumën 5.500.000 lekë dhe gjendje cash në shumën 1.200.000 lekë, në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht me të ardhurat e veta, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç

parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, mbështetur në faktin se deklaratimet e pasakta, të konstatuara në deklaratimet ndër vite, nuk cenojnë detyrimin e tij kushtetues, për deklaram të saktë në deklaratën “Vetting”, Komisioni çmon se pasaktësitë e konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, si dhe nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Komisioni vlerëson gjithashtu se pamjaftueshmëria, që rezulton nga analiza financiare nuk është e një madhësie të tillë, që të sjellë lindjen e dyshimeve për veprime që cenojnë figurën e prokurorit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...] (faqe 19 e vendimit). Në këto kushte, shumica e trupit gjykues të Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pas hetimit administrativ të thelluar, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

4.2.1 Në këtë konkluzion, Komisioni ka arritur pas administrimit të raporteve të DSIK-së, mendimit të përfaqësuesve të ONM-së, vlerësimin të provave të administruara, si dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka vërejtur se dy vendimet e formës së prerë, të dhëna për shtetasin ***.***, nga autoritetet gjyqësore italiane, përmbajnë dënime penale për kryerjen e veprave penale: (i) armëmbajtje pa leje dhe (ii) shtytje/nxitje në prostitucion, në territorin e një shteti tjetër në bashkëpunim. Komisioni ka konstatuar se veprat penale, pavarësisht rrethanave rënduese në të cilat ato janë kryer (përdorimi i dhunës), nuk kategorizohen si vepra penale të kryera nga struktura të “krimit të organizuar” sipas ligjit italian të kohës. Komisioni arsyeton se objekti i veprave penale për të cilat ***.*** është dënuar në Itali nuk i korrespondon ndonjë prej veprave të referuara nga pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se shtetasi ***.***, vëllai i subjektit të rivlerësimit, është një “person i përhirë në krimin e organizuar”.

4.2.2 Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] në një analizë të plotë të rrethanave të faktit dhe legjislacionit në fuqi, Komisioni konstaton se vepra penale për të cilën është dënuar ***.***, nga Gjykata e ***. Itali, nuk bën pjesë në grupin e veprave penale që hyjnë në krimin e organizuar dhe nuk klasifikohet si ajo e parashikuar nga neni 110/a, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili bën fjalë për: “Rekrutim, transportim, transferim, fshehje ose pritje e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo të formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, me qëllim shfrytëzimit e prostitucionit”. Pra, neni 110/a i Kodit Penal nuk përfshin shtytjen/nxitjen në prostitucion pa rrethana të agravuara, siç është rasti i shtetasit ***.***. Nga analiza e provave dhe fakteve rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të plotë dhe të sinqertë, duke tejkuluar edhe parashikimet ligjore. Ai ka dhënë detaje, të cilat e kanë çuar Komisionin në një hetim të plotë dhe të thelluar, hetim i cili arriti të zbardhë situatën dhe të zbehtë çdo dyshim të ngritur në fillim të fazës hetimore... Nga hetimi administrativ i Komisionit, nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të

përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të aneksit të Kushtetutës [.] (faqe 23, 24 e vendimit).

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga GPPP-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

5. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, shumica e trupit gjykues¹ të Komisionit, duke arsyetuar mbi parimin e proporcionalitetit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale e, për këto arsye, bazuar në germën “a”, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani me funksion prokuror/Drejtuës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë [...].*

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

6. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “C²”, e aneksit të Kushtetutës, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 29.7.2019, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: *“Rekomandim për paraqitje ankimi”* ndaj vendimit nr. 173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Artan Madani (bashkëlidhur këtij ankimi).

7. Objekti i këtij rekomandimi lidhet me vlerësimin dhe përfundimet e Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe, në mënyrë të përmbledhur, bazohet në këto elemente:

- i. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me apartamentin me sip.146,46 m² dhe garazh me sip. 10,5 m², janë të pasakta dhe të pamjaftueshme. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit dhe të përfaqësuesit të ONM-së.
- ii. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbi krijimin e depozitës në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank dhe vlera e *cash-it* të në shumën 1.200.000 lekë, janë të pasakta dhe të pamjaftueshme. Shpjegimet e subjektit nuk provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe nuk janë në linjë me logjikën ekonomike të analizës financiare.
- iii. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit, mbi automjetin me targa ***, formalisht në pronësi të z.***.***, janë të pasakta dhe të pamjaftueshme. Shpjegimet e subjektit nuk provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe nuk përputheshin me faktin që përdorimi i makinës nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti dhe se subjekti dhe familjarët e tij e përdornin në mënyrë intensive atë, duke arritur në përfundimin se subjekti ka *“de facto”* pronësinë mbi këtë automjet ose në çdo rast nuk ka deklaruar një pasuri në përdorim, të cilën duhej ta deklaronte në Deklaratën Vetting.
- iv. Rezultatet e analizës financiare për vitet objekt deklarimi tregojnë në mënyrë të qartë pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme

¹ Kryesuesi i trupit gjykues ka dalë në pakicë dhe ndan mendim të kundërt për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

² Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra [...]... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

pasuritë e vëna dhe shpenzimet e deklaruara. Shpjegimet e subjektit nuk provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit. Analiza financiare e paraqitur nga subjekti në përgjigje të analizës së paraqitur nga Komisioni, nuk mund të konsiderohet si provë e pretendimeve të tij.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

9. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

10. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni 7 i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij, për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

12. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 173/2019, i Komisionit dhe i akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Për këto rrethana të tilla ligjore e fakti, sikurse do të trajtojmë edhe në vijim, i jemi referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar të këtyre çështjeve.

13. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, ndër të tjera, rrethana dhe fakte ligjore të evidentuara nga Komisioni, për të cilat iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me: *(i)* pasaktësitë dhe pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurive në pronësi, si në deklaramet periodike vjetore (në vijim referuar si DV-) ashtu dhe në Deklaratën Vetting (në vijim referuar si D-Vett.); *(ii)* mosjustifikimi i vërtetësisë së deklaramëve mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive; *(iii)* pasaktësia dhe pamjaftueshmëria e deklaramëve për krijimin e depozitës në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank dhe për vlerën e *cash-it* në shumën 1.200.000 lekë, si dhe pamundësia për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna dhe shpenzimet e deklaruara; *(iv)* përpjekja për të fshehur dhe për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo në përdorim.

14. Gjithashtu, lidhur me deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, gjatë gjithë hetimit administrativ në Komision, vlerësojmë se duhen mbajtur në konsideratë dhe tregojnë se gatishmëria dhe sjellja gjatë procesit nuk ka qenë bashkëpunuese, në kuptim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016.

15. Në referencë të përmbajtjes së pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 59, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit.

16. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 173, datë 1.7.2019, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV. A Kontrolli i pasurisë

17. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Madani, rezulton se ka deklaruar: (i) në bashkëpronësi me ½ pjesë takuese, 2 (dy) pasuri të paluajtshme të llojit apartament banimi dhe garazh; (ii) likuiditete në formën e depozitës bankare (fond investimi) dhe *cash*-it në banesë.

19. Referuar “Rezultateve paraprake të hetimit administrativ”, Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me: (i) mënyrën e likuidimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 146.46 m² dhe garazh me sipërfaqe 10.5 m², kohën e përfundimit të tij, duke konstatuar pamjaftueshmërinë e burimeve të të ardhurave të ligjshme sipas analizës financiare; (ii) likuiditetet e deklaruara për krijimin e depozitës “****” pranë ***, gjendjes *cash* në banesë, duke konstatuar pamjaftueshmërinë e burimeve të të ardhurave të ligjshme sipas analizës financiare; (iii) rezultatet e analizës dhe treguesve financiarë ndër vite; (iv) mosdeklarimin e përdorimit të automjetit tip Ford Explorer, me targa ***, përdorur prej subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortja).

20. Për 2 (dy) pasuritë e paluajtshme të llojit apartament banimi dhe garazh, nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në: “*Deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie*”, dorëzuar në ILDKPKI më datë 24.3.2004 (këtu e në vijim referuar si “Deklarata e parë”), krahasuar me “*Deklaratën e pasurisë ‘Vetting’*”, dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.1.2016 (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), rezultojnë pasaktësi dhe pamjaftueshmëri për sa i përket: (i) llojit të pasurisë dhe vlerës së tyre dhe (ii) burimit të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive.

21. Pasuria nr. ***, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me sipërfaqe 146.46 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, rruga “****”, Durrës (në vijim referuar si

“Apartament banimi 146 m²”) dhe pasuria nr. *, me sipërfaqe 10.5 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, rruga “****”, Durrës (në vijim referuar si “Garazh 10 m²”).**

21.1 Në *D-Vett.*, subjekti deklaron: apartament banimi me sip. 146.23 m², dhe garazh 10.5 m², vlera 5.500.000 lekë dhe *burimi i krijimit*: (i) nga kursimet në vite e të ardhurave; (ii) pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

21.2 Në *Deklaratën e parë*, subjekti deklaron: apartament banimi 3+1, vlera 5.500.000 lekë dhe *burimi i krijimit*: (i) nga kursimet në vite e të ardhurave; (ii) pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

21.3 Subjekti i rivlerësimit, vetëm pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, deklaron, për herë të parë³, se ka marrë kontribute në formë dhurate nga i ati i bashkëshortes, z.***.*** (para dhe pas lidhjes së martesës), vëllai i bashkëshortes, z.***.***, si dhe detajon vlerën nga pjesëtimi vullnetar i shitjes së banesës së prindërve në vitin 2000.

21.4 Nga aktet në dosje që dëshmojnë rrethanat e krijimit të pasurive, ndër të tjera, rezultojnë:

(i) Kontratë shitblerje e datës ***.10.2004, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., lidhur në Shijak, noteri ***.***. Palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., palë blerëse Artan Madani, me objekt: pasuri e paluajtshme “apartament banimi” me sipërfaqe 146.46 m², për çmimin 1.700.000 lekë, shumë e shlyer jashtë zyrës noteriale, me vendndodhje në Durrës.

(ii) Kontratë shitblerje e datës ***.10.2004, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., lidhur në Shijak, noteri ***.***. Palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., palë blerëse Artan Madani, me objekt: pasuri e paluajtshme “garazh” me sipërfaqe 10.5 m², për çmimin 250.000 lekë, shumë e shlyer jashtë zyrës noteriale, me vendndodhje në Durrës.

(iii) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.5.2018, e ZVRPP-së Durrës, e cila konfirmon pronësinë e subjektit mbi pasuritë e paluajtshme, shoqëruar me dokumentacion.

(iv) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.11.2018, e ZVRPP-së Durrës, e cila konfirmon dokumentacionin e regjistrimit të godinës 6 kate në emër të shoqërisë “****” sh.p.k..

(v) Deklaratë noteriale e shoqërisë “****” sh.p.k., e datës ***.1.2001, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., bërë në Durrës, noteri ***.***. Deklarata ka për objekt regjistrimin e godinës së përfunduar.

(vi) Deklaratë noteriale e z.***.***, e datës ***.10.2018, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., bërë në Shijak, noteri ***.***. Deklarata ka për objekt deklarimin e dhënies së shumës prej 1.500.000 lekë, subjektit të rivlerësimit.

(vii) Deklaratë noteriale e z.***.***, e datës ***.6.2019, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., bërë në Durrës, noteri ***.***. Deklarata ka për objekt dhurimin e shumës 1.000.000 lekë në periudhën 1997-2002, vajzës, ***.*** (bashkëshortja e subjektit);

(viii) Deklaratë noteriale e z.***.***, e datës ***.6.2019, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., bërë në Durrës, noteri ***.***. Deklarata ka për objekt dhurimin e shumës 300.000 lekë në periudhën 2002-2003, motrës, ***.*** (bashkëshortja e subjektit).

(ix) Shkresa e *** Bank nr.*** prot., datë ***.4.2018.

21.5 Komisioni, pas analizës së bërë mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: [...]...*pavarësisht se analiza financiare për periudhën 1992 -2003 del me një balancë negative të fondeve në vlerë të vogël, nuk mund të vihet në dyshim aftësia financiare e subjektit për kryerjen e pagesave për prenotimin e këtyre pasurive dhe realizimin e shpenzimeve për përfundimin e apartamentit, kjo nisur edhe nga fakti se vlera totale e deklaruar e këtyre pasurive është e karakterit deklarativ dhe nuk disponohet ndonjë evidencë apo situacion punimesh lidhur me shpenzimet totale të kryera nga subjekti i rivlerësimit për*

³ Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit të Komisionit datë 22.6.2019, f. 5.

përfundimin e apartamentit. Duhet pasur parasysh që analiza financiare para vitit 2003 nuk ka një bazë të saktë për llogaritjeje, duke qenë se Komisioni nuk disponon të dhëna të sakta në lidhje me shpenzimet dhe koston e jetesës për person. Në këtë rast, balanca negative është - 163.765 lekë për 10 vjet, pra rreth 16.000 lekë në vit, vlerë e cila mund të jetë marzhi i gabimit në përlllogaritje dhe, për këtë arsye, nuk do të merret në konsideratë. Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesave për prenotimin dhe realizimin e shpenzimeve për pasuritë apartament dhe garazh [...] (faqe 15 e vendimit, pika 24.50).

21.6 Komisioneri Publik çmon se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe niset nga një premisë e gabuar për t'i dhënë vlerë provuese nivelit deklarativ të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket: (i) gjendjes “karabina” të pasurisë “*Apartament banimi 146 m²*”, (ii) lapsusit/harresës për mosdeklarim e pasurisë “*Garazh 10 m²*”, (iii) dhe kontributeve të padeklaruara më parë të të afërmëve të tij, të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara në Komision gjatë hetimit administrativ; (iv) shpenzimeve të jetesës për periudhën 1992-1997⁴. Komisioneri Publik gjen të pabazuar konkluzionin e lartpërmendur të arritur nga Komisioni, në lidhje me metodologjinë për llogaritjen e shpenzimeve dhe koston e jetesës për person për periudhën para vitit 2003. Ky vlerësim i Komisionit ka sjellë si pasojë dhe një qasje të gabuar në kryerjen e analizës financiare, ku, për vite me radhë, Komisioni ka llogaritur vetëm të ardhurat (1992-1997), pa përfshirë në analizë asnjë shpenzim për jetesë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së tij.

21.7 Gjithashtu, mënyra e zbatimit të ligjit nga Komisioni, lidhur me vlerën e D-Vett., në raport me deklaratat periodike, vlerën provuese të deklaratave noteriale dhe mbi kuptimin mbi deklarimin e burimit të krijimit të pasurisë, bie ndesh me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

IV.A.1 Për pasaktësitë dhe pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurive

21.8 Subjekti i rivlerësimit, pretendon se: (i) pasurinë “*Apartament 146 m²*” e ka blerë në gjendje “karabina”, (ii) pasurinë “*Garazh 10 m²*” e ka konsideruar të lidhur me pasurinë apartament; (iii) vlera prej 5.500.000 lekësh, e deklaruar në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë*, përfaqëson vlerën e apartamentit dhe garazhit.

21.9 Për pretendimin se (i) pasuria “Apartament banimi 146 m²” është blerë në gjendje “karabina”

Nga shqyrtimi i akteve në dosje rezulton se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, për arsyet në vijim:

- (i) Në përmbajtjen e dy kontratave të veçanta për secilën pasuri më vete, të nënshkruara nga vetë subjekti i rivlerësimit, më datë ***.10.2004, për blerjen e “*Apartament banimi 146 m²*” dhe “*Garazh 10 m²*”, është parashikuar shprehimisht se këto pasuri janë në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe figurojnë të regjistruara në regjistrin hipotekor nr. ***, datë ***.12.2001. Nga përmbajtja e kontratave nuk rezulton të jetë parashikuar gjendja “karabina” apo “i papërfunduar” i pasurive të shitura.
- (ii) “*Godina 6 +2 kate*”, ku gjenden këto pasuri, me investitor shoqëria “****” sh.p.k., është përfunduar në vitin 2000, vërtetuar me procesverbalin e kolaudimit të inxhinieres ***.***,

⁴ Në analizë të Komisionit, të ardhurat e subjektit nga punësimi i janë përlllogaritur nga viti 1992-2003, ndërsa shpenzimet e jetesës i janë përlllogaritur nga viti 1997-2003.

e datës ***.10.2000. Ky procesverbal është administruar si pjesë e dokumentacionit, që ka shërbyer për regjistrimin në ZVRPP Durrës. Bazuar në parashikimet e ligjit nr.7720, datë 14.6.1993, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, të ndryshuar, procesverbali i kolaudimit është garanci teknike dhe ligjore për dhënien e lejes së shfrytëzimit ose banimit të objektit.

(iii) Leja e shfrytëzimit (banimit), e datës ***.9.2000, me objekt “Banesë 8 kate”, me investitor “****” sh.p.k., është lëshuar nga Zyra e Urbanistikës pranë Këshillit të Rrethit Durrës, bazuar në ligjin 7720, datë 14.6.1993, dhe lejon shfrytëzimin për banim të këtij objekti.

(iv) Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.*** datë ***.8.2001, i cili ka marrë formë të prerë, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë të paditësit, shoqërisë “****” sh.p.k., duke detyruar të paditurin, ZVRPP Durrës, të bëjë regjistrimin në pronësi të paditësit banesë 8-katëshe dhe kati nën tokë, ndër të tjera, me arsyetimin se: [...] *Ndërtimi i banesës është bërë me leje të organeve kompetente shtetërore, ka përfunduar dhe është dhënë për shfrytëzim, ndërsa çështja e kateve është zgjidhur me vendim të gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë, prandaj dokumentacioni për regjistrimin e saj në ZVRPP është i plotë [...].*

(v) Deklarata noteriale (regjistrim fillestar) e datës ***.1.2001, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol. e shoqërisë “****” sh.p.k., administratorit të saj, z. ***.***, ka objekt regjistrimin e godinës së banimit.

(vi) Vërtetimi nga dokumentet hipotekore dëshmon se shoqëria “****” sh.p.k. ka regjistruar këto pasuri, në regjistrin hipotekor nr. ***, më datë ***.12.2001.

21.10 Në përfundim të sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti ka blerë pasurinë “*Apartament banimi 146 m²*”, të përfunduar plotësisht që në vitin 2000, pra është i pabazuar pretendimi se pasuria “*Apartament banimi 146 m²*” ishte në fazë karabinaje, dhe rëndon pozitën e subjektit, duke qenë në kushtet e deklaramit të rremë, për sa kohë pasqyrohet çmim artificialisht më i ulët në kontratën e shitjes. Subjekti i rivlerësimit pretendon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratave noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme dhe akteve të tjera zyrtare, të cilat në kuptim të ligjit përbëjnë provë të plotë.

21.11 Për pretendimin se: (ii) pasuria “*Garazh 10m²*” mendohej e lidhur me pasurinë apartament dhe se (iii) vlera prej 5.500.000 lekësh, e deklaruar në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë*, përfaqësonte vlerën e apartamentit dhe garazhit.

Nga shqyrtimi i akteve në dosje rezulton se ky pretendim është i pabazuar, për arsytet në vijim:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k. dy kontrata shitblerje në të njëjtën datë, më ***.10.2014, njëra për pasurinë “*Apartament 146 m²*”, të ndodhur në katin e 6 (gjashtë) dhe tjetra për pasurinë “*Garazh 10m²*”, i ndodhur në katin nën dhe. Nënshkrimi i këtyre kontratave të ndryshme nuk mbështet pretendimin se dy pasuritë ishin përfshirë në një kontratë.

(ii) Subjekti ka dy certifikata pronësie të ndryshme, paguan për secilën nga pasuritë dy vlera të ndryshme, të dy pasuritë regjistrohen secila më vete në ZVRPP Durrës, aplikimi për regjistrimin e pasurisë garazh 10 m² rezulton se është bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit.

21.12 Në përfundim për sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti ka bërë deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për dy pasuritë e lartpërmendura.

21.13 Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i Komisionit se: [...] *Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillojnë të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht deklarata “Vetting” dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me deklaramitën e re të pasurisë (“Vetting”),*

dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklaratime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Këto pasaktësi, në deklaratimin për herë të parë, nuk mund të shërbejnë si provë për të vërtetuar ndonjë qëllim të mundshëm për fshehje pasurie, për aq kohë sa është deklaruar saktë në deklaratën “Vetting”[...] (faqe 11 e vendimit, pika 24.31.), nuk është në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, tashmë të konsoliduar në këtë drejtim, lidhur me vlerën provuese të deklaratimeve të bëra në Deklaratat periodike dhe D-Vett., të cilën do ta trajtojmë në vijim.

21.14 Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me vlerën e D-Vett., në raport me Deklaratat periodike ndër vite, si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

21.14.1 Kolegji ka trajtuar në disa vendime edhe çështjen e raportit të D-Vett. me Deklaratat periodike ndër vite, konkretisht në vendimet (JR) nr. 9/2019, (JR) nr. 6/2018 dhe (JR) nr. 7/2018, (JR) nr. 8/2018, (JR) nr. 9/2018, (JR) nr. 10/2018, (JR) nr. 12/2018, (JR) nr. 19/2019, vendim i shkurtuar, pra ka vendimmarrje dhe është krijuar jurisprudencë, ku në vijim citojmë dy prej tyre:

(i) Në vendimin nr. 9/2019, Kolegji përcakton se: [...]nga ana e Komisionit është bërë në interpretim të gabuar të nenit D të aneksit të Kushtetutës. Vlerësohet se nuk është qëndrim i drejtë i Komisionit kur, në interpretim të pikës 2 të kësaj dispozite, konkludon:[...] Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklaratime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit[...]. Trupi gjykues sjell në vëmendje se Kushtetuta nuk duket të ketë parashikuar nga ana formale apo nga një interpretim harmonik i dispozitave përkatëse në asnjë moment vlerën (primare) të deklaratës së pasurisë (Vetting) 2017 apo të deklaratimeve të pasurisë në vite. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rendin e rëndësisë së deklaratimeve. Verifikimi i saktësisë dhe i plotësisë së deklaratimeve të subjektit, verifikimi i dyfishit të pasurisë, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklaratimeve vlerën e provës, përbëjnë në fakt kriteret në të cilat duhet të kalojë vlerësimi i pasurive të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës[.].

(ii) Në vendimin nr. 6/2018, Kolegji përcakton se: [...]Bazuar në përcaktimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 32, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit, nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë prej tij. Deklarimet e mëparshme të pasurisë, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, përbëjnë edhe bazën e vlerësimit krahasues për ILDKPKI-në, për përgatitjen e raportit përfundimtar, bazuar në nenin 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016... Në kuadër të procesit të rivlerësimit, shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mund të jenë edhe deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja. Kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, i shërben Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij [...].

21.15 Për mungesën e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme për krijimin e pasurive “Apartament banimi 146 m²” dhe “Garazh 10 m²”.

21.15.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Madani, në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë* deklaron si burime të krijimit të pasurive: (i) kursimet e të ardhurave dhe (ii) pjesëtimin vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000. Në *D-Vett.* sqaron se vlera sipas aktit të porosisë në vitin 2001, është 5.500.000 lekë, dhe për arsye të mospërfundimit të banesës, në aktet e shitblerjeve, vlera e apartamentit (karabina) është 1.700.000 lekë dhe garazhi 250.000 lekë, shpenzime të cilat janë kryer më pas për punimet.

21.15.2 Gjatë hetimit administrativ, për burimin e deklaruar nga pjesëtimi vullnetar i shitjes së banesës së prindërve në vitin 2000, subjekti pretendon se ka marrë shumën 1.500.000 lekë.

21.15.3 Për burimin e deklaruar: “kursimet e të ardhurave”

21.15.3.1 Bazuar në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë*, vlera e pasurisë: “Apartament banimi 146 m²” dhe “Garazh 10 m²” është deklaruar në shumën 5.500.000 lekë, nga aktet në dosje nuk rezulton dokumentacion justifikues ligjor për pagesat e kryera për këtë çmim, si edhe nuk rezulton të jetë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dokumentacion justifikues ligjor për kontributet e pretenduara gjatë procesit të rivlerësimit si të përfituara në formë dhurimi nga të afërmit.

21.15.3.2 Nga analiza financiare e Komisionit, për periudhën 1992–2003, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve për krijimin e të ardhurave të ligjshme në shumën - 163.765 lekë, pasi duket se nga ana e Komisionit i janë marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e tij mbi burimet e krijimit të pasurisë, pa shpjeguar ndonjë metodologji për këto përllogaritje.

21.15.3.3 Komisioneri Publik, për sa më lart lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, çmon se, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, nuk duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme: (i) dhurimet nga të afërmit e subjektit të rivlerësimit, në shumën totale 3.150.000 lekë⁵, të cilat do të trajtohen në vijim, si dhe (ii) të përfshihen në analizë shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-1997. Në këto kushte, balanca negative e të ardhurave të ligjshme për subjektin e rivlerësimit për periudhën 1992-2003 arrin në vlerën - 4.230.853 lekë.

21.15.3.4 Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklarin e pasurisë dhe burimit të të ardhurave të ligjshme për krijimin e saj, referuar *D-Vett.*, *Deklaratës së parë* dhe *DV-2004*.

21.15.4 Për burimin “pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000”

21.15.4.1 Në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë*, subjekti deklaron se burim krijimi i pasurisë është edhe pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000, pa dhënë ndonjë vlerë konkrete të këtij pjesëtimi. Gjatë hetimit administrativ në Komision ka pretenduar se: [...] *Kam biseduar me prindërit që bashkëjetonin dhe me vëllain tim, në lidhje me nevojën që kisha për të ndihmuar për blerjen e apartamentit tim. Babai im, ***,***, pasi shprehu gatishmërinë për të më ndihmuar, më dhuroi shumën prej 1.500.000 lekë [...].*

21.15.4.2 Komisioni është shprehur lidhur me mosdeklarimin e kësaj dhurate/ndihme financiare në deklaratat në *ILDKPKI*, duke mos e konsideruar si pasaktësi për shkak të: (i) kohës, para vitit 2001, kur nuk kishte bazë ligjore për deklarin e pasurisë dhe (ii) marrëdhënies të ngushtë familjare. Ndërkohë Komisioni, lidhur me mundësinë financiare të babait, z.***.***, për pagesën e shumës 1.500.000 lekë, pas analizimit të dokumentacionit të

⁵ Dhurimet: (i) 1.500.000 lekë nga babai i subjektit; (ii) 1.000.000 lekë nga vjehri; (iii) 300.000 lekë nga kunati, (iv) 350.000 lekë e deklaruar si e ardhur nga ana e bashkëshortes në momentin e martesës, si kursime të saj nga puna dhe dhuratë nga familja.

paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ka konkluduar se: [...] *babai i subjektit në fillim të viteve 2000 ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë/dhuruar shumën prej 1.500.000 lekësh subjektit të rivlerësimit [...].*

21.15.4.3 Komisioneri Publik nënvizon faktin se sipas Formularit A-1 në *Deklaratën e parë*, rubrika “Burim” ka shënimin “konkret dhe jo i përgjithshëm”. Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të deklaronte vlerën prej 1.500.000 lekë të pretenduar si të përfituar nga pjesëtimi vullnetar i shitjes së banesës në vitin 2000.

21.15.4.4 Ndërkohë, nisur nga fakti që kontratat e shitblerjes së dy pasurive “apartament” dhe “garazh” janë të datës ***.10.2004, subjekti i rivlerësimit në DV-2004 kishte detyrimin të deklaronte saktë këto të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë.

21.15.4.5 Për sa i përket ekzistencës së mundësisë financiare të z.***.*** për dhurimin e shumës prej 1.500.000 lekë, nga shqyrtimi i akteve në dosje, rezulton i pambështetur përfundimi që arrin Komisioni, për arsytet në vijim:

(i) në periudhën 2000-2002, babai i subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, ka realizuar të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme “Apartament banimi me sip. 65 m²”, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.12.2000, kundrejt vlerës prej 1.900.000 lekë dhe ka shpenzuar për blerjen e pasurisë së paluajtshme “Godinë 4 kat. [...]sipas kontratës së blerjes me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.3.2002, kundrejt vlerës 1.000.000 lekë.

(ii) z. ***.*** ka investuar për përfundimin e “Godinës 4 kate”, për të cilën subjekti ka deklaruar se ka qenë e përfunduar pjesërisht dhe është përfunduar më pas nga blerësi, z. ***.***.

(i) në emër të z. ***.***, pranë ***, më datë ***.10.2004, rezulton një llogari depozite në vlerën 1.000.000 lekë., e cila ka qenë e mbartur nga periudhat e mëparshme.

21.15.4.6 Në Deklaratën noteriale me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.10.2018, z.***.*** deklaron se burimet për financimin e dhurimit ishin jo vetëm nga shitja e apartamentit, por edhe të ardhurat e dërguara nga emigracioni, gjatë asaj periudhe, prej vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit ***.***.

21.15.4.7 Nga aktet në dosje, vëllai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi ***.***, rezulton se në atë periudhë është dënuar me vendim të formës së prerë së autoriteteve gjyqësore italiane, për kryerjen e krimeve të “Armëmbajtjes” dhe “Nxitje prostitucioni në territorin e një shteti tjetër, kryer në bashkëpunim”, në territorin e Republikës së Italisë.

21.15.4.8 Këto rrethana të provuara, mbi të ardhura që kanë si burim aktivitete të paligjshme, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në analizimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të ligjshme të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, burime të cilat deklarohen të jenë përdorur për krijimin e pasurisë dhe që nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues ligjor, për të vërtetuar ndonjë burim alternativ të ligjshëm të krijimit të tyre nga shtetasi ***.***.

21.15.4.9 Komisioneri Publik nënvizon se konkluzioni i Komisionit është bazuar vetëm në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e paraqitura nga ai, të cilat jo vetëm që nuk janë të mjaftueshme për të provuar të kundërtën për sa ka rezultuar nga hetimi administrativ, por përmbajnë rrethana kontradiktore.

21.15.5 Në përfundim për sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi pretendimi i tij dhe konkluzioni i Komisionit, bazuar në këtë pretendim, se kishte mungesë baze ligjore për deklaramin e kontributeve sikundër janë dhuratat, nuk qëndron, për sa kohë që në formularin e Deklarimit të parë është specifikuar

qartësisht detyrimi për të deklaruar burimin e krijimit të pasurisë. Për sa kohë ky dhurim ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, subjekti kishte detyrimin ligjor ta specifikonte që në Deklaratën e parë. Në referencë të nenit D të aneksit të Kushtetutës, nuk provohet ekzistenca e burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme për vlerën e deklaruar në formë dhurate nga z.***.***.

21.15.6 Për burimin e të ardhurave të ligjshme për dhuratat e marra nga z.*.*** (babai i bashkëshortes së subjektit) dhe z.***.*** (vëllai i bashkëshortes së subjektit)**

21.15.6.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, sikundër u tha më lart në këtë ankim, vetëm pas kalimit të barrës së provës për diferenca negative të të ardhurave që kishin shërbyer për krijimin e pasurisë, pretendoi se ka marrë dhurata nga: (i) z.***.*** shumë 1.000.000 lekë; (ii) z.***.***, 300.000 lekë; si dhe (iii) ka përdorur shumë 350.000 lekë të bashkëshortes, marrë si dhuratë nga familja e saj për martesë.

21.15.6.2 Komisioni rezulton se ia ka marrë në konsideratë këto të ardhura subjektit të rivlerësimit, duke i përfshirë në analizën financiare për periudhën 1992-2003⁶, si dhe është shprehur se pasaktësia e treguar nga subjekti për mosdeklarim të këtyre dhurimeve në DV ndër vite dhe Deklaratën Vetting, duke i konsideruar si *kursime të tij në vite*, nuk mund të sjellë pasoja në këtë proces, pasi nuk cenon ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

21.15.6.3 Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt me përfundimet që ka arritur Komisioni, si për sa i përket: (i) vlerës së dhënë deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, kundrejt deklarimeve ndër vite dhe Deklaratës Vetting, ashtu edhe (ii) përfshirjes së tyre në analizën financiare për periudhën 1992-2003, për arsyet në vijim:

(i) Subjekti i rivlerësimit, për të provuar aftësinë financiare të z.***.***, për shumë 1.000.000 lekë, ka paraqitur 3 kontrata shitblerje trualli për periudhën 1996-2001, në shumë totale prej 3.240.000 lekësh⁷. Ndërkohë, Komisioni nuk analizon se në të njëjtën periudhë (1996-2000) z.***.***, babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ka investuar në ndërtimin e “Banesës 4 kate”, shitur në vitin 2002 babait të subjektit të rivlerësimit.

(ii) Gjithashtu, shumata totale prej 3.240.000 lekësh, po t’i referohemi deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, do të pakësohej, pasi pretendohet fakti se z.***.*** i ka dhuruar *cash* para martese znj.***.***, bashkëshortes së subjektit, shumë 350.000 lekë, shumë e padeklaruar më parë dhe që konsiderohet e nivelit deklarativ.

(iii) Subjekti i rivlerësimit, ka qenë kontradiktor në shpjegimet e tij, kur i referohej formës së kontributit të pretenduar (dhuratës), të marrë nga i vëllai i bashkëshortes. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kontributi i tij ishte në natyrë, në funksion të rregullimit të banesës, ndërsa në seancën dëgjimore të datës 27.6.2019, në përgjigje të pyetjes së përfaqësuesit ndërkombëtar për të qartësuar formën e kontributit të kumatit, ky pretendim ka ndryshuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kunati kishte paguar për punimet ndërtimore në apartament vlerën prej 300.000 lekësh.

21.15.6.4 Edhe në këtë rast, Komisioneri Publik vëren se rezulton e provuar se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi pretendimi i tij dhe konkluzioni i Komisionit se kishte mungesë baze ligjore për deklarimin e kontributeve si dhurata, nuk qëndron, për sa kohë në formularin e Deklarimit të parë është specifikuar qartësisht detyrimi

⁶ Referohuni faqes 15 të vendimit.

⁷ Referohuni faqes 13 të vendimit, paragrafi 24.43.

për të deklaruar burimin e krijimit të pasurisë. Për sa kohë ky dhurim ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, subjekti kishte detyrimin ligjor ta specifikonte që në Deklaratën e parë.

21.15.7 Në përfundim për sa më sipër, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa kohë nuk i ka deklaruar këto të ardhura si burime të krijimit të pasurisë në Deklaratën e parë, DV-2004 dhe D-Vett. Nuk provohet me dokumentacion ligjor justifikues mundësia financiare e dhurimit nga z.***.*** dhe z.***.*** ndaj dhe nuk konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës, vlerat e dhuruara prej tyre.

21.15.8 Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me vlerën e Deklaratave noteriale gjatë hetimit administrativ

21.15.9 Kolegji, në jurisprudencën e tij, ka trajtuar edhe çështjen e vlerës së Deklaratave noteriale, konkretisht në vendimin (JR) nr. 6/2018, (JR) nr.10/2018, pra ka vendimmarrje dhe është krijuar jurisprudencë, ku në vijim citojmë:

(i) Në vendimin nr. 6/2018, Kolegji përcakton se: [...]Në lidhje me kontratat e shitjes së pasurisë së paluajtshme të vitit 2008, trupi gjykues vlerëson se, megjithëse subjekti i rivlerësimit është përpjekur t'i justifikojë ato me deklaratë noteriale të personit tjetër të lidhur ***.***, edhe nëse kjo deklaratë do të kishte përmbajtjen e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, përsëri nuk do të kishte vlerë provuese, pasi nuk është bërë në momentin e krijimit të të ardhurave dhe nuk ka asnjë dokumentacion provues për kalimin e këtyre të ardhurave nga personi tjetër i lidhur te subjekti i rivlerësimit[.].

(ii) Në vendimin nr.10/2018, Kolegji përcakton se: [...] Lidhur me Deklaratën noteriale të znj.***.***, në cilësinë e shitëses së apartamentit, për momentin kur deklaroi se i ka kthyer mbropsht subjektit të rivlerësimit shumën prej rreth 24.000 euro të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe të disbursuar në llogarinë e saj bankare, nga analiza e provave të gjendura në dosje, vlerësojmë se nuk ekziston asnjë dokument bankar dhe/ose financiar apo akt noterial i kohës kur pretendohet të jetë kthyer kjo shumë, që të vërtetojë kalimin e kësaj shume te subjekti i rivlerësimit e, për rrjedhojë, nuk justifikohet as rikonstruksioni i apartamentit në vlerën prej 13.000 euro, deklaruar nga subjekti që të jetë bërë me këto të ardhura[.]

21.16 Në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament 146 m²” dhe pasurinë “Garazh 10 m²”, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, provohet deklarimi i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga subjekti i rivlerësimit, mbi pasuritë “Apartament 146 m²” dhe pasurinë “Garazh 10 m²”.

22. Për mungesën e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme për investimin në Fondin e Investimeve “*”, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank, dhe për krijimin e gjendjes cash në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë, dhe rezultatet e analizës të treguesve financiarë ndër vite.**

22.1 Në D-Vett., subjekti deklaroi: Depozitim në *** Bank (fond investimi) 5.500.000 lekë dhe gjendje cash në banesë 1.200.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursimet nga të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes.

22.2 Në DV-2014, subjekti deklaroi: Depozitim në *** Bank, në vlerën 4.000.000 lekë (blerje kuotash), mbetur gjendje cash në banesë shuma 2.400.000 lekë, dhe shtuar cash-i në banesë 400.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga kursimet vjetore të deklaruar periodikisht si cash në banesë

dhe dy llogaritë bankare 8.000 USD, në ***.*** Bank, dhe 1.079.132 lekë, tërhequr nga llogaria e pagës.

22.3 Në DV-2016, subjekti deklaron: Depozitim në *** Bank, në vlerën 1.500.000 lekë, duke ia shtuar vlerës së mëparshme të deklaruar në vitin 2014. Burimi i krijimit: Nga gjendja *cash* në banesë, në datë ***.10.2016. Nga aktet në dosje, ndër të tjera, janë administruar:

(i) Shkresa nr.*** prot., datë ***.4.2018, e *** Bank, përmes së cilës i janë përcjellë Komisionit lëvizjet e llogarive bankare për subjektin, bashkëshorten dhe babain e subjektit të rivlerësimit.

(ii) Shkresa nr.*** prot., datë ***.4.2018, e ***.*** Bank, përmes së cilës i janë përcjellë Komisionit lëvizjet e llogarive bankare për subjektin dhe bashkëshorten.

22.4 Nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve bankare, ashtu sikurse dhe Komisioni ka konstatuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka investuar në Fondin e Investimeve “***”, në *** Bank, shumat si më poshtë:

i. në datë ***.1.2014, është investuar shuma 4.000.000 lekë⁸ dhe

ii. në datë ***.10.2016, është investuar shuma 1.500.000 lekë.

22.5 Komisioni, për të vlerësuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën totale prej 5.500.000 lekësh, investim në fondin “***” pranë *** Bank, si dhe mundësinë e kursimit të gjendjes *cash* në banesë, prej 1.200.000 lekësh, ka kryer analizën financiare për periudhën 2004-2016. Analiza e treguesve financiarë e Komisionit, referuar rezultateve të hetimit administrativ, ka treguar se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2004-2016, rezulton me një balancë negative fondesh, në vlerën -2.700.059 lekë, rrethanë kjo për të cilën i është kaluar barra e provës.

22.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, paraqiti shpjegime, prova dhe një analizë financiare të përgatitur nga vetë ai. Pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhen me: (i) shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit⁹; (ii) shpenzimet e jetesës për vitet 2005 dhe 2007¹⁰; (iii) konsiderimin si e ardhur e ligjshme e vlerave të depozituara në bankë nga bashkëshortja e subjektit dhe babai i bashkëshortes, në vitet 2006, 2007¹¹; (iv) përlllogaritjen në zërin “të ardhura” të vlerave të përfituara nga bonusi i karburantit dhe dietat¹².

22.7 Rezulton se Komisioni, pasi i vlerësoi pretendimet e subjektit, i mori pjesërisht në konsideratë dhe, konkretisht, reflektoi në analizën e treguesve financiarë për vitet 2004 - 2016: (i) të ardhura shtesë për periudhën janar - maj të vitit 2008; (ii) dhurimet e deklaruara; (iii) reduktim shpenzimesh për udhëtimet; (iv) reduktim i shpenzimeve jetike për vitin 2007; dhe (v) reduktim i shpenzimeve të transportit. Edhe pas këtyre veprimeve, që Komisioni duket se i kreu pa iu referuar një metodologjie të qartë ligjore dhe financiare, analiza financiare e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, sërish rezultoi me një balancë negative në total për shumën -1.383.254 lekë.

22.8 Në përfundim, Komisioni, ndër të tjera ka vlerësuar se [...]pas analizës financiare të përditësuar mungesa e likuiditeteve (balancat negative), të shtrira përgjatë viteve, nuk janë në

⁸ Nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve bankare në *** Bank, konstatohet se, në datë ***.1.2014, është depozituar *cash*, jashtë sistemit bankar, shuma prej 3.000.000 lekë; dhe po në këtë datë është transferuar shuma prej 1.000.000 lekësh nga llogaria rrjedhëse në llogarinë për blerje kuotash në *** Bank.

⁹ Reduktim të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit për vlerën 7.725 euro (f.11 e shpjegimeve të datës 22.6.2019).

¹⁰ Subjekti ka pretenduar se shpenzimet e jetesës paraqesin anomali në raport me ndikimin e inflacionit, për vitin 2005 janë 38% më të larta se të vitit 2004, ndërsa shpenzimet e vitit 2007 janë 115% më të larta se të vitit 2006 (f.12 e shpjegimeve të datës 22.6.2019).

¹¹ Shumën prej 350.000 lekë, të depozituar më datë ***.4.2006, nga bashkëshortja e subjektit, në ***, si dhe shumën prej 250.000 lekësh, të depozituar më datë ***.2.2007, nga vjehri i subjektit, me përkrahimin: z. ***.*** depoziton për ***.***, në ***.

¹² Referohuni pyetësorit të datës 4.12.2008, në dosje të Komisionit.

masën që të cenojnë besimin e publikut. Ky përfundim arrihet pasi natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti (balancë negative fondesh) nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit [...] (faqe 18 e vendimit, pika 25.14).

22.9 Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt me argumentimin që përdor Komisioni në vendimin e tij, qoftë në interpretimin ligjor, por edhe me elementet e analizës financiare.

22.10 Përkundër detyrimit që Komisioni ka për të mbështetur vendimin e tij në provat dhe ligjin e zbatueshëm, përfundimi i lartpërmendur i shumicës së trupit gjykues në lidhje me balancat negative, metodologjinë e analizës financiare dhe ndikimin që këto elemente të rivlerësimit kanë në shkarkimin eventual nga detyra të subjektit, në gjykimin e Komisionerit Publik është i pabazuar.

22.11 Komisioneri Publik, në kuadër të vlerësimit të elementeve përkatëse, nënvizon se në analizën financiare të Komisionit nuk duheshin marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të paraqitura në materialin “*Parashtrimet e datës 22.6.2019*”, pretendimet dhe provat e reja të paraqitura gjatë hetimit administrativ, si dhe deklaratimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet të pashoqëruara me dokumentacion ligjor justifikues, të cilat duhet të reflektoheshin në zërat të ardhura dhe shpenzime, për sa vijon:

- (i) Shpenzimet e jetesës për vitin 2007¹³ nuk janë llogaritur referuar të dhënave të korrespondencës me ILDKPKI-në.
- (ii) Të ardhura të deklaruara dhe të padeklaruara më parë nga subjekti në Deklaratat periodike vjetore¹⁴, nuk duhen pasqyruar në zërin të ardhura; pasi nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit.
- (iii) Shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit, që vijnë në kundërshtim me vetë deklaratimet e subjektit, përdorur në funksion të nevojave të tij për të mbuluar diferencat negative ndër vite¹⁵; duheshin përllogaritur bazuar në të dhënat e sistemit TIMS dhe në zbatim të metodologjisë orientuese të Kolegjit (vendimi (JR) 11/2019).
- (iv) Shpenzimet e rivlerësimit të pasurisë “apartament banimi 146 m²” për vitin 2011¹⁶, duheshin përllogaritur në zërin shpenzime.
- (v) Vlerat e përfituara nga bonusi i karburantit dhe dietat, nuk duheshin përllogaritur në zërin “të ardhura”, pasi nuk është në përputhje me metodologjinë orientuese të Kolegjit (vendimi (JR) 7/2019)¹⁷.

22.12 Komisioneri Publik, duke marrë në konsideratë të gjithë elementet e sipërpërmendura, vlerëson se balanca negative e fondeve për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2004-2016 do të arrijë në vlerën - 4.333.111 lekë. Nisur nga kjo rezulton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me ndryshimin e vlerës së likuiditeteve ndër vite janë tregues i faktit se në vijimësi subjekti ka deklaruar kursime *cash*, të cilat nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme. Në rrethana të tilla,

¹³ Reduktimi i shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, ka bërë që rezultatet e analizës financiare në këtë vit nga një balancë negative në vlerën - 490.661 lekë, referuar rezultateve të hetimit administrativ, të arrijnë në një balancë pozitive në vitin 2007, referuar vendimit të Komisionit, prg. 25.11.

¹⁴ Të ardhura për periudhën 2004-2016, rezultojnë të jenë përafërsisht në shumën 1.072.730 lekë, konkretisht: deklaruar në DV 2007, dhuruar nga kunati shuma 500 euro; shuma prej 350.000 lekë të depozituar më datë ***.4.2006, nga bashkëshortja e subjektit, në ***, si dhe shuma prej 250.000 lekësh, të depozituara më datë ***.2.2007, nga z.*** ***, të dyja këto shuma të padeklaruara; shuma prej 3.000 euro, deklaruar në DV-2015, pagesa e shkollimit të vajzës nga z.*** ***.

¹⁵ Reduktimi i shpenzimeve të udhëtimit jashtë shtetit për vlerën 7.725 euro, bazuar vetëm në shpjegimet e subjektit. Subjekti deklaroi në mënyrë kontradiktore shpenzimet e udhëtimit për pushime në Greqi, ku në DV- 2016 deklaroi vlerën 2.500 euro, ndërsa në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ deklaroi vlerën 1.500 euro.

¹⁶ Shpenzime rivlerësimi banese në vitin 2011, në vlerën 89.834 lekë.

¹⁷ Vlera e bonuseve të pretenduara arrin gjithsej në vlerën 350.000 lekë, ndërsa vlera e dietave arrin shumën 999.500 lekë.

Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës.

22.13 Komisioneri Publik, referuar balancës negative të fondeve për periudhën 2004-2016, çmon se referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për investimin në depozitën “***”, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank, dhe gjendjes *cash* në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë.

23. Për mosdeklarimin dhe fshehjen e pasurisë së luajtshme autoveturë e markës Ford, modeli Explorer, me targë ***

23.1 Subjekti i rivlerësimit në D-Vett., dorëzuar më datë 26.1.2017, nuk deklaroi pasuri të luajtshme në pronësi apo përdorim të tij apo personit të lidhur. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: [...] *ka përdorur një automjet Ford me targa ***; me raste të veçanta, për udhëtime kryesisht lëvizje/udhëtime familjare, i cili është në pronësi të z.***.***, mik i familjes, sipas një akti përdorimi të veçantë në vitet 2014-2016, i revokuar pas janarit 2017 [...].*

23.2 Në këto rrethana, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse në lidhje me të drejtat pasurore të tij mbi këtë automjet dhe mbi dyshimet e ngritura se subjekti ka ndërmarrë hapa dhe është përpjekur të fshehtë pasuri në pronësi apo në përdorim të tij.

23.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka pretenduar se: [...] *Sa më sipër, udhëtimet me automjetin Ford janë bërë vetëm me raste të veçanta dhe nuk ka qenë gjatë gjithë vitit, asnjëherë në vazhdimësi, pasi është një pasuri e disponuar dhe e poseduar nga z.***.***, si një pasuri vetëm e tij, ndaj dhe nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë nga ana ime [...].*

23.4 Në dosjen të Komisionit, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera, është administruar:

- (i) shkresë nr.*** prot., datë ***.4.2018, e DPSHTRR-së, Tiranë, e cila informon Komisionin se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë mjete në pronësi pranë Drejtorisë Rajonale, Tiranë;
- (ii) të dhëna mbi polica sigurimi, nxjerrë nga sistemi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që rezultojnë të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, si përdorues të siguruar të mjetit tip Ford;
- (iii) të dhëna mbi lëvizjet ndërkuftare me mjetin tip Ford, nxjerrë nga të dhënat e sistemit TIMS për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur;
- (iv) deklaratë noteriale me nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2019;
- (v) vërtetim me nr. *** prot., datë ***.6.2019, nga ***; dega Durrës;
- (vi) vërtetim i datës ***.6.2019, nga ***.***.***;
- (vii) kopje të certifikatës së pronësisë dhe e lejes së qarkullimit të mjetit me targa ***;
- (viii) certifikatë e kontrollit teknik nga “***”, me vlefshmëri deri në datën 25.7.2019.

23.5 Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i akteve në dosje, ka rezultuar se:

- i. Automjeti tip “Ford Explorer”, me targa ***; zyrtarisht në pronësi të z.***.***, ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit në periudhën qershor 2015-2016, 2016-2017, dhe më pas ka qenë në përdorim nga bashkëshortja e subjektit për periudhën nga qershori 2017 - qershor 2018.
- ii. Të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS kanë konfirmuar se subjekti dhe/ose familja e tij, kanë kaluar kufirin shqiptar me këtë automjet gjithsej 35 herë në periudhën ***.6.2014-***.2.2018 (në së paku 10 raste me bashkëshorten e tij dhe ndonjëherë së bashku me fëmijët).

iii. Automjeti në fjalë është i llojit SUV, me vlerë të konsiderueshme financiare, ku nga verifikimet, i njëjti model i ri (5-vjeçar) kushton rreth 25.000 euro.

23.6 Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka ardhur në përfundimin se deklaratimet e subjektit, lidhur me pronësinë dhe përdorimin prej tij të këtij automjeti, janë bindëse. Sipas Komisionit është e provuar se shtetasi ***.*** është pronar i dy automjeteve dhe ka pasur mundësi financiare për blerjen e tyre. Në arsyetimin e Komisionit është parashtruar se nuk disponohen të dhëna që shtetasi i sipërcituar, i cili i ka dhënë në përdorim këtë automjet subjektit të rivlerësimit, të jetë me rekorde kriminale, i përfshirë në krimin e organizuar ose i dyshuar si i përfshirë në krimin të organizuar. Me këtë arsyetim, Komisioni ka ardhur në përfundimin se nuk qëndrojnë dyshimet e ngritura paraprakisht në rezultatet e hetimit, për të cilat i është kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit.

23.7 Në lidhje me këtë qëndrim të Komisionit, Komisioneri Publik çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, i referohen vetëm faktit të pronësisë ligjore të z.***.*** mbi automjetin dhe nuk japin shpjegime mbi shkaqet e mosdeklarimit të përdorimit të këtij mjete nga ana e tij, sikundër ligji urdhëronte.

23.8 Po ashtu, shpjegimet e subjektit, që udhëtimet e shumta të realizuara me këtë automjet, të rezultuara gjatë hetimit administrativ nga të dhënat e sistemit TIMS, kanë të bëjnë me faktin se ka udhëtuar shpesh me destinacion Tropojën (*arsye për të cilën ka hyrë dhe ka dalë nga kufiri me Kosovën*) nuk mbështeten nga përmbajtja e akteve në dosje, nga të cilat rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur dhe përtej këtyre destinacioneve.

23.9 Nuk mund të merret në konsideratë fakti se, në emër të pronarit të ligjshëm të automjetit, z.***.***, nuk është plotësuar asnjë policë sigurimi për automjetin për lëvizjet jashtë territorit shqiptar (Kartoni Jeshil), ndërkohë që të gjitha këto polica sigurimi kanë qenë në emër të subjektit të rivlerësimit.

23.10 Në këto rrethana, duket se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit për këtë marrëdhënie nuk gjejnë mbështetje me përmbajtjen e akteve të administruara në dosje, duke mohuar ushtrimin e të drejtave (përdorimi) në mënyrë të vazhdueshme e të pandërprerë, në kufijtë e pronësisë.

23.11 Nisur nga sa u parashtrua më lart, Komisioneri Publik, referuar nenit D, pikat 1 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me përdorimin e automjetit në fjalë, është në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të fshehjes së ushtrimit të të drejtave mbi këtë send.

V. Kërkimi i ankimit

24. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, dispozitat e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.

25. Komisioneri Publik vjen në përfundimin se, referuar nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës, nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut, pasi: (i) nuk ka deklaruar saktë dhe mjaftueshëm të dhënat e pasurisë; (ii) nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme burimet e ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme për pasuritë në pronësi të tij, si dhe (iii) ka bërë përpjekje për të fshehur ose pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim të tij.

26. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

27. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

28. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi nr. 911 prot., datë 26.7.2019, i ONM-së.